



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 422 Prot.

Fier, më 10.03. 2022

LËNDA: NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Në mbështetje të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr.99, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimin nr.2, datë “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, DRAP Fier shpall vendet e lira të punës si drejtues institucioneve arsimore në ZVAP-ve në juridiksionin e saj sipas listës bashkëlidhur:

1. Aplikantët e intereuar për pozicionet e drejtuesve të institucioneve arsimore duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:

- a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” me vlerësimin jo më pak se “mirë”, në kualifikimin e fundit.
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- d) të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar ose të jetë pranuar për ta kryer atë.

2. Aplikantët për pozicionin e drejtorit në IPAP duhet të dorëzojnë.

- a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- b) kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;
- c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vërtetim nga shkolla e drejtorëve që është pranuar për të kryer trainimin e detyrueshëm.
- f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.


Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2, dorëzohet nëpërmjet **shërbimit postar** në ZVAP-në përkatëse ku ndodhet shkolla në të cilën aplikanti këkon të konkurojë.

Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se dhjetë ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për drejtor të IPAP në faqen elektronike zyrtare të DRAP.


Bashkëlidhur do të gjeni listën me vendet vakante për çdo ZVAP.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

DREJTOR



FLUTURA MEÇAJ



GRAFIKU I KONKURSEVE PER DR.SHKOLLAVE

FAZA E PARE

11.03.2022 - 06.05.2022

Nr	Shkolla	ZVA	Periudha
1	HIQMET BUZI	FIER	
2	EUROPA	FIER	
3	YMER XHAFA	FIER	
4	3 DESHMORET	FIER	
5	KRISTAQ SHTEMBARI	FIER	
6	PINELLOPI PIRRO	FIER	
7	THANAS LASKA	FIER	
1	DERVISH HEKALI	MALLAKASTER	
2	SHMB "DERVISH HEKALI"	MALLAKASTER	
3	GJYSHO KAREMANI	MALLAKASTER	
4	RAMIZ ARANITASI	MALLAKASTER	
1	NIMETE PROGONATI	TEPELENE	
1	MELEQ GOSNISHTI	PATOS	
2	HEKURAN MANEKU	PATOS	
1	SHKOLLA KSAMIL	SARANDE	
1	ALUSH GREPCKA	ROSKOVEC	
2	AJET TOSKA	ROSKOVEC	
1	KAMBER BENJA	KELCYRE	
1	SADIK ZOTAJ	SELENICE	
1	ISMAIL VEIZI 9-VJ.	DIVJAKE	
2	TAFIL DOGA 9-VJ.	DIVJAKE	
3	MITI ZOI DAKA MES.	DIVJAKE	
4	KOLI SAKO 9-VJ.	DIVJAKE	
1	JANI NUSHI MES.	LUSHNJE	
2	AZEM QUKA 9-VJ.	LUSHNJE	
3	MIHAL DAVIDHI 9-VJ.	LUSHNJE	
4	PALI DANI MES.	LUSHNJE	
5	RIZA IBRALIU 9-VJ.	LUSHNJE	
6	FIERSHEGAN	LUSHNJE	
1	PETRO POGA	GJIROKASTER	
2	URANI RUMBO	GJIROKASTER	
1	SHKOLLA FINIQ	FINIQ	
1	15 TETORI	VLORE	
2	JANI MINGA MES	VLORE	

